

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Keshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 299, date 8.5.2003

PER

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE VENDIMIN NR.219, DATE 16.5.2002, TE KESHILLIT TE MINISTRAVE, "PER MBROJTJEN E RRACES AUTOKTONE TE BUAJVE NGA ZHDUKJA"

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes, te nenit 16, te ligjit nr. 7627, date 21.10.1992. "Per Sherbimin Zooteknik", dhe te ligjit nr.8379, date 29.7.1998, "Per hartimin dhe zbatimin e buxhetit te shtetit te Republikes se Shqiperise", me propozimin e ministrit te Bujqesise dhe te Ushqimit, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

Ne vendimin nr.219, date 16.5.2002, te Keshillit te Ministrave, te behen keto shtesa dhe ndryshime:

1. Ne piken 1 shtohet nje fjali me kete penllbajtje: "Pragu i gjendjes kritike per t'u zhdukur eshte 100 krere riprodhues, te rritur, femra (buallica) dhe 8 krere riprodhues, te rritur , meshkuj (buaj).
2. Ne piken 3, fjalet "...per vitin 2002.", zevendesohen me "...per nje periudhe 5-vjecare, cieri ne kalimin e pragut te gjendjes kritike per t'u zhdukur."
3. Pika 4 ndryshon si me poshte vijon:
4. Efektet financiare, qe rrjedhin nga zbatimi i ketij vendimi, te perballohen nga buxheti vjetor i miratuar per Ministrine e Bujqesise dhe te Ushqimit".
4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqesise dhe e Ushqimit per zbatimin e ketij vendimi.
Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet cieri me date 31.12.2008.

KRYEMINISTRI

FATOS NANO

MINISTRI I BUJQESISE DHE I USHQIMIT

AGRON DUKA

